

- 2 Shkurtime reale të paagve në ndërtimtari** Të prekur me dhjetëra mijëra punëtorë
- 3 12 dhjetor: Dita Ndërkombëtare e Migrantëve** Aktivitete të ndryshme nëpër regjione
- 4 Horizonte shkon drejtë digjitalizimit** Mundësi informimi pavarësisht afateve kohore

Nr. 7 | Dhjetor 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

2024-ta do të jetë vit vendimtar për sigurimin e pensionit të pleqërisë në Zvicër

Puna jonë meriton pensione të mira



Pamje nga manifestimi për pensionin e 13-të të AHV/AVS i organizuar nga pensionistët e Unia dhe partnerëve e 25 shtatorit 2023 në Bernë

Në mars 2024, ne do të votojmë dy propozime. Së pari, nismën tonë AHV/AVS x 13, e cila synon rritjen e pensioneve, e për të cilën ne duhet të angazhohemi dhe të ndihmojmë që kjo nismë të triumfojë. Së dyti, të refuzojmë nismën tjetër të pensioneve, e cila dëshiron të rrisë moshën e pensionit në 67 vjeç. Qëllimi është që, në vitin 2024, të parandalohet përkeqësimi i mëtejshëm i pensioneve dhe forcimi i AHV/AVS-së.

Brigitta Bernet, eksperte e politikave sociale e arsimore, drejtorja politike, Unia

75 vjet më parë, Zvicra themeloi shtyllën e saj më të rëndësishme të mirëqenies sociale, AHV/AVS. Pensioni AHV ka për qëllim të na garantojë sigurinë themelore financiare në pleqëri, edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje të grumbullojmë pasuri të mëdha. Siç thotë Kushtetuta Federale – Neni 112 – ky pension bazë duhet të jetë i mjaftueshëm për të «mbuluar në mënyrë të përshtatshme nevojat e ekzistencës». Është koha e fundit që duhet të zbatojmë këtë qëllim të kushtetutës dhe jo siç duan borgjezët që ti shmangen dhe të anashkalojnë këtë qëllim kushtetues.

Po për forcimin e shtyllës së parë

Ne sot jemi më larg se kurrë nga mandati kushtetues i një pensioni jetësor. Sot, fuqia blerëse e pensioneve është në rënie për shkak të inflacionit. Qirartë, energjia elektrike, ushqimet – çdo gjë po shtrenjtohet. Ato që mbeten nga pensioni edhe ashtu i ulët marrin një goditje tjetër shkatërrimtare

nga çekani i primeve të arkave të sigurimit shëndetësor. Ato do të rriten përsëri edhe për 8,7% gjatë vitit që vjen. Shumë pensionistëve tashmë u ka mbetur fare pak për të jetuar. Zhvillimi i viteve të fundit ka pasur një ndikim goditës veçanërisht për njerëzit me pensione të ulëta. Në mesin e tyre, numerikisht mbi mesataren, janë shumë gra dhe migrantët. Për shkak se çmimet po rriten, pensioni i tyre ka vlerë gjithnjë e më pak. Ndërkohë, inflacioni si dhe premitë e sigurimeve shëndetësore gllabërojnë një muaj pension.

Na duhet rritja e pensioneve – tani!

Kjo është arsyeja pse tani ka një nevojë urgjente për një përmirësim të pensioneve për të siguruar që vrima në kuletat e pensionistëve të mos bëhet edhe më e madhe. Këtu hyn nisma AHV/AVS x 13, e cila do të hidhet në votim më 3 mars 2024. Nisma është e thjeshtë, por magjepsëse: ajo kërkon fuqizimin e pagesës së mëtejshme të

pensionit, bazuar në të drejtën nga AHV/AVS. Njëjtë sikur shumë njerëz që marrin një pagë të 13-mujore. Llogaritur në një pagesë mujore, kjo do të thotë një rritje e menjëhershme e pensioneve AHV prej 8.3 për qind. Ata që përfitojnë më shumë nga një pension i 13-mujor janë ata që gjatë jetës së tyre të punës fitojnë të ardhura të ulëta dhe të mesme. Kjo është e drejtë dhe korrekte, sepse janë pikërisht pensionistët më të varfër ata që kanë më shumë nevojë për përmirësim. Pensioni i 13-të AHV/AVS mund të kompensojë humbjen e fuqisë blerëse dhe për këtë arsye vjen në kohën e duhur!


Jo rritjes së mëtejshme të moshës së daljes në pension!

Nga ana tjetër, nisma e paarsyeshme e pensioneve të rinjve liberalë, e cila gjithashtu do të hidhet në votim më 3 mars 2024, është gjithmonë e gabuar. Ajo kërkon një rritje të moshës së pensionit – së pari në 66 vjeç, pastaj në 67 vjeç e më tej. Në tryezë është një plan

tipik i shkurtimeve social nga rrethi i bankave të mëdha, kompanive të sigurimeve dhe përfaqësuesve të tyre politikë. Rritja e moshës së pensionit në 67+ është jorealiste, sepse njerëzit në moshën 55+ tashmë po shtyen jashtë tregut të punës. Por nisma është gjithashtu tepër e padrejtë dhe anti-sociale: ajo i detyron njerëzit me të ardhura të ulëta të punojnë deri sa të dërrmohen. Ndërsa, ata që jetojnë më gjatë mund edhe të përballojnë ende pensionin e parakohshëm. Nisma e pensionit është një shuplakë për të gjithë ata që bëjnë punë të rëndë fizike dhe për këtë arsye kanë një jetëgjatësi më të shkurtër – dhe si pasojë gjithsesi një pension të shkurtër. Të punosh më gjatë për më pak pension? Kjo nuk vjen në shprehje!

PO pensionit të 13-të mujor të AHV/AVS (AHV/AVS x 13), Jo nismës së pensionimit (67+)! Le të përcaktojmë kursin në vitin 2024, por në mënyrën e duhur!

Editorial



Migracioni është i mirë për shtyllën e parë të sigurimit të pensioneve të pleqërisë AHV/AVS. Ne, migrantët, paguajmë më shumë në AHV/AVS dhe marrim shumë më pak përfitime. Kjo situatë do të vazhdojë edhe për dekadat e ardhshme. Është gjithashtu një fakt se, migrantet mesatarisht fitojnë më pak se gratë zvicerane dhe për këtë arsye janë më pak në gjendje të kursejnë për kohën pas moshës së punës. Migrantet e migrantët që punojnë në sektorët me pagë të ulët dhe gratë që gjithashtu nuk kanë qenë në gjendje të paguajnë në shtyllën e dytë të sigurimeve shoqërore për shkak të punës së kujdesit në shtëpi, në pleqëri janë të varura të sigurojnë jetesën e tyre nga pensioni AHV/AVS. Sot, rritja e qirave, premitëve të sigurimeve shëndetësore dhe çmimet e energjisë e hanë pensionin e një muaji të tërë. Kështu që është koha e fundit që diçka të ndryshojë. Pensionistët meritojnë një pension 13-mujor me qëllim që t'ia dalin mbanë në pleqëri dhe të mos rrëshqasin më thellë në varfëri. Kjo është arsyeja pse ky votim është kaq i rëndësishëm. Pra, nëse votoni me PO më 3 mars 2024, do jepni një kontribut për njerëzit që kanë punuar shumë dhe meritojnë një jetë me dinjitet.

Propozimi tjetër i liberalëve të rinj synon që moshën e daljes në pension ta lidhë me jetëgjatësinë. Ata fillimisht duan që dalja në pension të fillojë me 66 ose 67 vjeç dhe pastaj gjithmonë të rrisin më tej moshën e daljes në pension. Jetëgjatësia e migrantëve është mesatarisht 5 vjet më e ulët se ajo e njerëzve të lindur këtu. Prandaj ne nuk duam që njerëzit që çdo ditë bëjnë punë të vështirë fizike të punojnë derisa të vdesin. Kjo është e padrejtë e anti-sociale dhe rrezikon solidaritetin ndërmjet gjeneratave. Prandaj: JO rritjes së moshës së daljes në pension.

Ju uroj festa të lumtura të fundvitit dhe një pushim të mbarë në rrethin e të dashurve tuaj. Mirupafshim!

Hilmi Gashi

News

Pensionet e sigurimit profesional vijojnë të ulen edhe më tej

Bazuar në statistikat e reja të pensioneve për vitin 2022, pensionet nga shtylla e dytë e sigurimit profesional për meshkuj janë në nivelin më të ulët të të gjitha kohërave. Që nga viti 2015, ato janë ulur me 9,5 për qind. Dhe ky zhvillim as që është duke marrë parasysh shtrenjtimin e kostos jetësore. Kjo për shkak se pensionet e fondit të pensioneve nuk përshtaten me inflacionin. Që nga viti 2015, kjo ulje nënkupton një humbje shtesë në vlerë prej pothuajse 5 për qind. Pensionistët po lihen në baltë. Ata sot kanë më pak para për të jetuar. Për Bashkimin e Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS), është e qartë se kjo rënie e pensione mund të kompensohet vetëm me miratimin e nismës popullore për një pension të 13-të AHV/AVS.

Paga minimale më të larta për punëtorët e përkohshëm

Pas negociatave intensive, partnerët socialë të KKP-së për personelin e huazuar – sindikatat Unia dhe Syna, Shoqata Tregtare Zvicerane, ajo Punonjësit e Zvicrës dhe Shoqata e Punëdhënësve të Ofruesve të Shërbimeve të Personelit Zviceran «swissstaffing» – kanë rënë dakord për KKP-në e katër viteve të ardhshme. Pagat minimale në KKP për të personelin e huazuar zbatohen për punëtorët e përkohshëm në sektorët edhe pa KKP-në e tyre dhe është përgjithësisht detyruese. Pagat minimale do të rriten me 3,2% në 2024. Në vitet në vijim deri në vitin 2027, ato do të rriten të paktën në masën e inflacionit dhe, për shumicën e kategorive, konkretisht me një shtesë prej 1%. Partnerët socialë ka paraqitur kërkesën në Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) për të deklaruar KKP-në e re mbi personelin e huazuar si përgjithësisht të zbatueshme nga 1 janari 2024 për një periudhë prej katër vjetësh, në mënyrë që të vazhdohet kontributi i rëndësishëm në mbrojtjen e pagave dhe kushteve të punës zvicerane.

Dumpingu në paga: «Perëndimi i egër» në kantierin e ndërtimit të spitaleve në Sion



Gjatë ndërtimit të fushës për uljen e helikopterëve për spitalin e ri në Sion, montuesit marrin vetëm gjysmën e pagës, përkatësisht 14.98 euro në orë. Ata janë

të punësuar të përkohshëm nga një kompani e huaj, e cila nuk vepron në përputhje me ligjin. Punonjësit mashtrohen gjithashtu kur vjen puna te shpenzimet: ata marrin vetëm 10 franga në ditë për vaktet, ndonëse Kontrata Kolektive e Punës (KKP) parashikon 18 franga. Në tërësi, punonjësit mashtrohen me rreth 3000 franga në muaj. JO vetëm kaq, sepse që nga 22 tetori nuk kanë marrë fare paga, edhe pse është rënë dakord për një pagesë javore. Ky rast aktual tregon edhe një herë rëndësinë e masave shoqëruese (FLAM) në fuqi. Unia po i bën thirrje drejtuesve të spitalit që të ndalojnë shkeljen e ligjit për kantierin e ndërtimit dhe të sigurojnë që punonjësit të marrin pagën e tyre të plotë.

Ligji mbi çerdhet e fëmijëve: tani nevojitet një zgjidhje e shpejtë dhe e drejtë e sociale

Një nga kërkesat kryesore të grevës feministe të 14 qershorit 2023, në të cilën dolën në rrugë 300 mijë vetë, është pajtueshmëria e jetës profesionale dhe asaj të punës. Kjo është e mundur vetëm me mjedise të mjaftueshme dhe të përbalueshme për kujdesin ndaj fëmijëve. Në mënyrë që më në fund t'i afrohem këtij qëllimi të krijimit të shërbimeve të përbalueshme dhe gjithëpërfshirëse të kujdesit për fëmijët në Zvicër, duhet t'i sigurojmë me kohë financimin e përhershëm. Aktualisht, kujdesi për fëmijët në Zvicër, krahasuar në rrafshin ndërkombëtar, është jashtëzakonisht i nënfinancuar. Ka mungesë të vendeve të kujdesit për fëmijët. Stafit i kujdesit është i mbingarkuar. Kostoja për familjet është jashtëzakonisht e lartë. Prandaj SGB/USS është e angazhuar të sigurojë e të garantohen një model subvencionimi të kujdesit institucional të përkujdesjes së mjaftueshme, të qëndrueshme dhe afatgjatë. Koha nuk pret. Vonesave të panevojshme duhet t'u vijë fundi. Ne kemi nevojë për një përmirësim të shpejtë në financimin e kujdesit për fëmijët.

Shkurtime reale të pagave në ndërtimtari

Të prekur me dhjetëra mijëra punëtorë të ndërtimtarisë

Shoqata e sipërmarrësve të ndërtimit është përgjegjëse për të vetmin raund zero të kësaj vjeshte pagash! Në fund të tetorit, ata ndërprejnë njëanshmërisht negociatat e pagave me sindikatat pa bërë asnjë ofertë. Kjo do të thotë humbje të mëtejshme në pagat reale për një pjesë të madhe të punëtorëve të ndërtimtarisë. Duke pasur parasysh inflacionin e lartë prej 6,4% që nga viti 2020, ata me shifra reale tani kanë deri në 4% më pak pagë sesa në vitin 2020.

Hilmi Gashi

Prej vitesh janë rritur fitimet në industrinë kryesore të ndërtimit. Fitimet arritën një rekord të ri këtë vjeshtë. Librat e porosive janë gjithashtu plot. Nga ana tjetër, situata për punëtorët e ndërtimtarisë është jashtëzakonisht e vështirë: gjithnjë e më pak punëtorë të ndërtimtarisë po bëjnë gjithnjë e më shumë punë dhe presioni i afateve po rritet. Dhe humbja reale e pagave për shumë punëtorë të ndërtimtarisë në tre vitet e fundit ka qenë rreth 4%.

Sipërmarrësit për veti përlogarisin inflacionin – por refuzojnë kompensimin për punonjësit

Shoqata e sipërmarrësve të ndërtimit u rekomandon «urgjentisht» anëtarëve të saj të mos nënshkruajnë kontrata për punë dhe shërbime me ndërtuesit pa kompensim automatik të inflacionit. Dhe kjo me të drejtë. Është edhe më e pakuptueshme që po e njëjta shoqatë kundërshton çdo rritje të përgjithshme të pagave. Fakti që gjërat mund të bëhen ndryshe tregohet nga sektorët e industrisë së ndërtimit, ku një rritje e përgjithshme e pagave këtë vjeshtë u negociua pothuajse kudo – në disa raste ndjeshëm mbi inflacionin.



Pamje nga njëra nga demonstratat e punëtorëve të ndërtimtarisë

Punëtorët e ndërtimtarisë nuk do të qëndrojnë duarkryq

Vendimi i shoqatës së sipërmarrësve që, pikërisht në zhvillimin aktual të ekonomisë, të ndërmerr një reduktim real të pagave për industrinë e ndërtimit është i papërgjegjshëm dhe mungesë respekti për punëtorët e ndërtimtarisë. Ndërprerja e njëanshme e negociatave nga shoqata e

sipërmarrësve të ndërtimit bie gjithashtu në kundërshtim me të gjitha rregullat e partneritetit kontraktual.

Punëtorët e ndërtimtarisë janë të zhgënjyer dhe do të bëjnë fushatë edhe më energjike për një rritje të drejtë të pagave gjatë vitit që vjen.

Infermeria në pushim mjekësor

Masat e menjëhershme dhe financimi i drejtë i kujdesit është ilaqi!

Infermierët demonstruan nën moton «Masat e menjëhershme dhe financimi i kujdesit të drejtë është mjekimi më i mirë!» Më 26 nëntor, ata në sheshin federal në Bernë bënë thirrje për masa të menjëhershme me një fushatë të madhe mirëmbajtjeje. Situata në kujdes dhe në përgjithësi në infermeri po bëhet gjithnjë e më e pasigurt. Edhe një vit pas miratimit të nismës së infermierisë, 300 infermierë në muaj po largohen ende nga profesioni i tyre. Kjo është e rrezikshme, sepse së shpejti nuk do të jetë më e mundur të sigurohet kujdesi i duhur.

Emine Sariaslan

Ikja në infermeri po vazhdon, sepse asgjë nuk ka ndryshuar që nga miratimi i nismës së kujdesit dhe infermierisë: Masat e menjëhershme që kërkuam në Bundesplatz në nëntor 2022 nuk janë ndërmarrë, kushtet e këqija të punës dhe financimet e pamjaftueshme po e sëmurin më tej infermierinë. Kështu, një kujdes i mirë për të moshuarit: prindërit dhe gjyshërit tanë është në rrezik. Veçanërisht për mirëqenien e banorëve të shtëpive të plqëve dhe pacientëve, prandaj po vazhdojmë presionin dhe po këmbëngulim në kërkesat tona, thonë infermierët. Ata do të vazhdojnë të luftojnë deri në përmirësimin e kushtet të tyre të punës!

Pesë kërkesat e infermiereve

Përveç zbatimit të shpejtë të nismës së kujdesit e infermierisë, demonstruesit nga konfederata dhe kantonet kanë kërkuar 5 masa të menjëhershme:

- Pagat/ orari i punës:** Rritje e ndjeshme e pagave për të njëjtën ngarkesë pune ose reduktim i orarit të punës për të njëjtën pagë.
- Shtesat:** Rritje masive e shtesave ekzistuese dhe bonueve të kohës, si dhe futja e shtesave për ndryshimet afatshkurtra të planit të punës.
- Pushimet:** Minimumi 5 javë deri në moshën 49 vjet, nga 50 vjet 6 javë, nga 60 vjet 7 javë.
- Regjistrimi faktik dhe kompensimi i kohës së punës:** p.sh. duke përfshirë kohën e ndërrimit të veshjes, kohën e udhëtimit nga një detyrë në tjetrën në Spitex.
- Kujdesi për fëmijët:** Subvencione për kujdesin plotësues ndaj fëmijëve përveç familjes.



Infermierët në aksion: Kujdesi i mirë ka nevojë për kushte të mira pune!

Ligji nuk i mbron mjaftueshëm punonjësit e kujdesit, infermierisë dhe mbështetjes. Për shembull, ata kanë periudha më të shkurtra të pushimit se sa pjesa tjetër e fuqisë punëtore dhe mund të planifikohen më shpesh për punë në fundjavë. Kushtet e punës, veçanërisht për punonjësit në shtëpitë e kujdesit dhe të pleqve, rrallë rregullohen nga Kontratat Kolektive të Punës (KKP). Kushtet e këqija të punës kanë ndikim edhe në shëndetin e infermiereve, gjë që është një nga arsytet pse pothuajse gjysma e tyre largohen nga profesioni.

Mobilizimi ia vlen

Pagat në raport me shtrenjtimitin po vijnë të çalojnë

Rritja e përgjithshme e pagave reale, veçanërisht në sektorët e zejeve të ndryshme dhe në KKP-të e rëndësishme terciare, do të ofrojë mbështetje shumë të nevojshme për fuqinë blerëse për 700 000 punëtorë. Kështu punëmarrësit më në fund do të marrin pjesën e tyre të merituar. Mobilizime edhe më të forta do të nevojiten vitin e ardhshëm.

Marie Saulnier Bloch

Rreth 20000 veta demonstruan në demonstratën kombëtare për fuqinë blerëse më 16 nëntor në Bernë. Ndërsa më 7 tetor 2023, rreth 1200 teknikë ndërtimi dhe elektrikistë ishin dal në rrugët e Cyrihut. Me sukses:

- Me KKP-në e saj më të madhe në zeytari, Unia ka arritur të realizojë rritje pagash përtej shtrenjtimit të kostos jetësore. 120 franga më shumë në përgjithësi në teknologjinë e ndërtimit, që korrespondon me 2,5% dhe më shumë për pagat më të ulëta, p.sh. të arritura praktikisht në të gjitha zeytet me përmbylljen e negociatave për paga parashikojnë gjithashtu rritje përkatëse apo edhe rritje dukshëm më të larta të pagave më të ulëta. Përmirësimet më të mëtejshme do të bëhen rast pas rasti, të tilla si pagesat e shpenzimeve e të drejtat e pushimeve.

- Kontratat e rëndësishme Unia në sektorët e shërbimeve parashikojnë më shumë se vetëm kompensimin e inflacionit. Për shembull: në «Coop», pagat deri në 4800 franga përgjithësisht

rriten me 140 franga, pra rritje mes 2,9% dhe 3.3%. Në KKP-në për personelin e huazuar të gjitha kategoritë me 3,2% për. Në sektorin e floktarisë, në varësi të kategorisë, nga 1,8% në 12,5%.

Në industri pritet të zhvillohen shumica e negociatave të pagave. Fakti që tregon se rritja është e mundur të realizohet, është p.sh. Përmbyllja e negociatave për paga me fonderinë (shkriptoren) «Nottaris», në të cilën të gjithë punonjësit marrin një rritje prej 4%. Tek prodhuesi ushqimor «Wander», pagat minimale do të rriten me 200 franga zvicerane dhe pagat efektive me 2,3% (të përgjithshme + individuale).

Megjithatë, humbjet reale të pagave prej 2,7% mesatarisht të akumuluar në 2021 dhe 2022 nuk mund të kompensohen nga përmbyllja e negociatave ekzistues të pagave. Ne kemi fituar disa beteja, por jo ende luftën: bllokada e pagave në ndërtimtarit është një sfidë e madhe. Prandaj, për t'u dhënë më në fund punëtorëve pjesën që u takon, mobilizimet edhe shumë më të forta janë të nevojshme vitin e ardhshëm.



Pamje nga demonstrata e 16 nëntorit 2023 në Bernë për paga të drejta dhe fuqinë blerëse

12 dhjetori: Dita Ndërkombëtare e Migrantëve

Përrjashtimi u shkon përshtati vetëm punëdhënësve!

Punëtorët që nuk kanë pasaportë të kuqe me kryq të bardhë, punëtorët sezonalë, punëtorët të huazuar e të dërguar, punëmarrës ndërkufitarë, migrantë pa dokumente: ka situata të shumta që dita e 18 dhjetorit i venë në pah. Bashkohuni me aksionet në regjionin tuaj dhe ftoni migrantët e rrethit tuaj të bashkohen me Unia në regjionin e tyre!

Marie Saulnier Bloch

Në vitin 2000 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, data 18 dhjetor, u shpall Dita Ndërkombëtare e Migrantëve. Kjo datë na kujton edhe miratimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre të 18 dhjetorit 1990, të cilën Zvicra deri më sot as nuk e ka nënshkruar dhe as ratifikuar.

Unia është organizata më e madhe e migrantëve në Zvicër. Së bashku, kërkojmë, ndër të tjera: Ndalni diskriminimin në bazë të origjinës dhe statusit të qëndrimit, politika më përfshirëse dhe më humane të migracionit dhe azilit, trajtimin të barabartë për të gjithë, paga të ndershme dhe kushte të sigurta të

punës dhe tolerancës zero për sulmet raciste në vendet tona të punës dhe në rrugë.

Çdo vit, Grupi i Interesit (GI) i Migracionit organizon aktivitetet nëpër regjione. Për shembull, më 18 dhjetor 2023 do të zhvillohet një aksion në sheshin federal (Bundesplatz) në Bernë, organizuar nga GI Migracion për regjionin e Bernës: një mundësi e mirë kjo për të sensibilizuar parlamentarët! GI Migracion i regjionit Neuchâtel (Neuenburg) organizon gjithashtu festën e vogël tradicionale të popujve të mëdhenj më 17.12.2023, festë kjo që garanton një moment të përzemërt! Interesohuni dhe pyetni për aktivitetet e planifikuara në zonën tuaj këtë vit dhe mos hezitoni të pro-

pozoni idetë tuaja dhe të ndihmoni – çdo pjesëmarrje është e mirëpritur!



Intervistë



Ngacmimi në vendin e punës: çfarë të bëjmë?

Shumë punonjës ankohen për ngacmime seksuale në vendin e punës. Horizonte foli me Aude Spang, Sekretare e Mundësive të Barabarta të Unias.

Kur është një sjellje e caktuar ngacmimi seksual?

Për shkak se shpesh nuk e dinë se çfarë do të thotë saktësisht kjo, shumë gra mendojnë se nuk kanë përjetuar kurrë ngacmime. Me fjalë të tjera, çdo sjellje e lidhur seksualisht që perceptohet si e padëshirueshme nga personi i ngacmuar përbën ngacmim seksual. Sjellja ngacmuese, pa përjashtuar edhe aspekte tjera mund të përfshijë: vërejtjet rreth karakteristikave seksuale (p.sh., rreth figurës), deklaratat e padëshiruara për seksualitetin, shikimet provokuese apo gjestet, shfaqjen e materialit pornografik, prekjën, apo edhe përdhunimin.

Sa i përhapur është ngacmimi në vendin e punës?

Anketa e fundit i kryer nga Zyra Federale për Barazi Gjinore dhe SEKO mbi ngacmimet në vendin e punës është nga viti 2008: asgjë që atëherë! Faktet ishin dërrmuese: Sipas sondazhit, çdo e 3-të grua ngacmohet seksualisht gjatë jetës së saj profesionale. Që nga lëvizja #MeToo dhe greva feministe e 14 qershorit 2019, megjithatë, ne kemi vërejtur më shumë vetëdije për problematikën: shumë më tepër gra kanë filluar të raportojnë ose të mbrohen kundër ngacmimeve seksuale.

Në vitin 2019, Unia zhvilloi një anketë me nxënësit. Cilat ishin rezultatet?

Anketa tregoi se 33% e nxënësve ishin ngacmuar të paktën një herë në vendin e punës, duke përfshirë 80% të femrave të anketuara dhe pothuajse një në dy meshkuj. Kjo është serioze: nxënësit janë veçanërisht të prekshëm për shkak të gjendjes së tyre të varësisë. Më shumë se një çështje seksuale, ngacmimi seksual është qartësisht një çështje pushteti. Dhe në shumicën dërrmuese të rasteve, format «më të dobëta» të ngacmimeve, të tilla si insinuatat seksuale apo vërejtjet nënçmuese, nuk ndodhin vetëm, por në kombinim me forma të tjera «më të forta». Çdo formë ngacmimi është pra një tregues se ka ndodhur një problem strukturor dhe për këtë arsye një nevojë për veprim.

Çfarë bën tjetër Unia në lidhje me ngacmimet në vendin e punës?

Në sektorin e mikpritjes (gastronomisë), gjithashtu, një anketë e bëri të qartë se sa punonjës në këtë degë janë prekur nga ngacmimet seksuale dhe bullizmi. Përveç kësaj, tema ka të bëjë edhe me gratë në ndërtimtarit, të cilat janë veçanërisht të ekspozuara ndaj rrezikut të ngacmimit në të ashtuquajturat sektore mashkullore. Andaj, në këta sektorë edhe janë planifikuar fushata për këtë temë.

Unia është pjesë e platformës www.belaestigt.ch, e cila ofron këshilla falas në disa gjuhë. Dhe çdo vit Unia marrë pjesë në fushatën «16 ditë kundër dhunës me bazë gjinore», ku trajtohet dhuna në vendin e punës. Unia ka edhe një broshurë (unia.ch/de/arbeitswelt/von-a-z/sexuelle-belaestigung) dhe ofron këshilla e mbështetje në rast problemesh.

Çfarë mund të bëjnë vetë punonjësit kundër ngacmimeve?

Dëshmitë janë të rëndësishme; duhet shkruar dhe mbajtur shënime për çdo gjë që ka të bëjë me ngacmimin. Duhet t'i bëhet e qartë autorit ngacmues (nëse është e nevojshme gjithashtu më vonë edhe me shkrim) se sjellja e tillë është e padëshirueshme. Gjithashtu mund të ndërmerren edhe veprime ligjore. Në shumë raste, megjithatë, ka kuptim të provohet që paraprakisht konflikti të zgjidhet në një mënyrë tjetër. Nuk duhet të mbeten vetëm me problemin, por të kërkon këshilla dhe mbështetje të mira nga mjedisi juaj. Ngacmimi në vendin e punës është i ndaluar me ligj! Mos harroni se vlen gjithmonë: Mbrojtja është detyrë e punëdhënësit, mbrojtja e vetes është e drejta juaj.

Marilia Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

I sëmurë rëndë: A mund të më largojë nga puna shefi im?

Unë (55 vjeç) kam qenë i punësuar në një biznes të vogël familjar për 5 vjet. Tani jam shumë i sëmurë. Për fat të keq, nuk është e parashikueshme se kur do të jem në gjendje të punoj përsëri me kohë të plotë. Në varësi të gjendjes sime shëndetësore, jam 20 deri në 40 për qind në gjendje të punoj. Nëse kam një sigurim të pagesës së mëdijve në rast sëmundjeje që paguan për 720 ditë. Shefi im ka bërë të ditur se ata ndoshta së shpejti do të duhet të plotësojnë vendin tim të punës. Kam frikë se së shpejti do më largojnë nga puna, kështu që natyrisht jam shumë i shqetësuar për ekzistencën time financiare. A mund të më largojë shefi im nëse unë nuk jam në gjendje të punoj?



FRIKA EKZISTENCIALE:
Paaftësia për të punuar
shkakton shumë shqetësim.
(Foto: Alamy)

Regula Dick: Ju nuk mund të ju largojë gjatë paaftësisë suaj për punë për një periudhë të caktuar kohore. Ka një të ashtuquajtur periudhë bllokimi. Ju jeni në vitin tuaj të 5-të të shërbimit, kështu që periudha juaj e bllokimit zgjat 90 ditë. Pasi të hyni në vitin e 6-të të shërbimit, ka një periudhë bllokimi prej 180 ditësh. Kjo do të thotë se periudha e bllokimit do të zgjatet. Në këtë rast zbriten ditët e bllokimit që tashmë kanë skaduar. Për fat të mirë, ju keni sigurimin e pagesës së mëdijve për sëmundjet. Është e këshillueshme të pyesim tani nëse bëhet fjalë për një sigurim të pagesës së mëdijve të sëmundjeje që garanton përfitime për sëmundjen tuaj edhe pas përfundimit të kontratës së punës, apo nëse është e nevojshme të kaloni në sigurimin individual të pagesës së mëdijve. Nëse është e parashikueshme që ju do të mbeteni të paaftë për të punuar për një kohë shumë të gjatë, ju duhet të lajmëroheni për regjistrim në sigurimin për invaliditet IV/AI, në çdo rast me së voni pas gjashtë muajsh.

(Work, 11/17/23)

Përrashtimi: A do të marr ende kompensimin për shpenzimet?

Punëdhënësi më largoi nga puna duke më lënë pa punë. Periudha e afatit të njoftimit për përjashtim në rastin tim është tre muaj, ndërsa kam edhe pesë javë pushime dhe edhe 200 orë pune shtesë jashtë orarit. Përveç kësaj, unë kam të drejtë për një pagesë shpenzimi prej 300 franga në muaj dhe gjithashtu të drejtën të përdori privatisht makinën e ndërmarrjes. Kontrata ime e punës nuk rregullon orët shtesë. As çështjen e kompensimit të shpenzimeve gjatë afatit të periudhës së largimit nga puna. A kam ende të drejtë për to, dhe a duhet të marr pushimet tani? Dhe çfarë ndodh me makinën e ndërmarrjes?

Regula Dick: Gjatë periudhës së largimit e përjashtimit nga puna, punëdhënësi juaj ju detyrohet atë që do t'ju duhej t'ju paguante po të kishit punuar. E drejta për përdorimin e lirë të makinës së ndërmarrjes ekziston gjithashtu. Meqë keni rënë dakord për kompensim paushallë të shpenzimeve, këto duhet të paguhen ende. Kjo do të ishte ndryshe vetëm nëse do të kishit rënë dakord se do të rimburoheshit vetëm për kompensimin e shpenzimeve të dëshmuara e të faturuara. Gjatë largimit, ju keni ende një të drejtë pushimi, të cilën ose mund ta merrni ose duhet t'ju paguhet në fund të marrëdhënies së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore, mund të supozohet se mund të pritët që si pushime ju të merrni rreth një të tretën e periudhës së afatit të largimit nga puna. Orët shtesë jashtë orarit të punës nuk keni pse ti merrni si pushim. Kështu që, këto duhet t'ju paguhen.

(Work, 11/17/23)

Aksidenti: Tre ditë pa pagë?

Kohët e fundit, pata një aksident në punë dhe për këtë shkak nuk isha në gjendje të punoja për tri javë. Dëshmia ime e pagës tregon pagesat e mëdijve nga sigurimi i aksidentit, por me sa duket nuk kam marrë asgjë për tre ditët e para pas aksidentit. A është e lejueshme kjo?

Myriam Muff: Jo. Është e vërtetë se, sipas Ligjit për Sigurimin e Aksidenteve, sigurimi i detyrueshëm i aksidenteve nuk ka pse t'i rimburojë punëdhënësit tuaj një dëmshpërblim të mëdijve prej 80 për qind të pagës së siguruar deri në ditën e tretë pas aksidentit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ju duhet të mbeteni duarbosh në tre ditët e para. E drejta obliguese zvicerane përcakton se punëdhënësit për të zëvendësuar pagën duhet të paguajnë vetë, nëse kompania e sigurimit paguan vetëm pas një periudhe pritjeje.

(Work, 11/3/23)

Të dashurja lexues | e të Horizonte: Çezaur festat e fundvitit dhe gjitha të mirat për vitin e ri 2024!

«Horizonte» fillon të digjitalizohet

Shumica e njerëzve që jetojnë në Zvicër duhet të kenë marrë një njoftim nga kompania e tyre e sigurimeve shëndetësore me informacione e premive për vitin 2024. Vitin e ardhshëm duhet paguar mesatarisht 8.7 për qind më shumë për sigurimet shëndetësore. Çfarë mund të bëhet për të kursyer në premitë?

Hilmi Gashi

«Horizonte» u themelua për të informuar koleget e kolegët tanë me sfond migracioni në gjuhën e tyre të kuptueshme rreth zhvillimeve rreth migracionit dhe politikën e sindikatave. Në cilësi të mirë, ne sjellim në formë të shtypur si gazetë në letër shtatë herë në vit në shqip kontributet gjuhësore mbi KKP-të, pagat, nismat, intervistat, portretet, agjendat për ngjarjet. Përveç kësaj, ne u përgjigjemi pyetjeve të anëtarëve tanë në çdo çështje.

Si gazetë shumëgjuhëshe e sindikatës Unia, «Horizonte» iu është bashkangjitur gazetave të Unia si Work (në gjermanisht), L'Événement (në frëngjisht) dhe Area (në italisht). Kjo bashkëngjitje në brendësi të këtyre gazetave më të mëdha ndonjëherë e bën të vështirë «zbulimin» e gazetës Horizonte. Nëse dikush nuk lexon një nga gazetave qendrore të Unia dhe e lenë anash pa hapur atë, «Horizonte» nuk zbulohet fare.

Regjistrohu në «Horizonte»

Vega dhe kodi QR



Digjitalizimi si një mundësi

Ndërkohë, mundësitë për marrjen e informacionit janë bërë më të ndërlukuara. Digjitalizimi dhe përdorimi i gjerë i platformave të mediave sociale si Facebook, Instagram, Twitter hapin mundësi të reja për të arritur anëtarët tanë dhe anëtarët potencialë. Ky zhvillim është gjithashtu një mundësi për Unia dhe «Horizonte» për të arritur më shumë njerëz me informacionin tonë shumëgjuhësh dhe gjithashtu për të shpërndarë këtë informacion nëpërmjet mediave sociale.

Nga viti 2024, «Horizontet» do të publikohen katër herë në formë letre (gazete të shtypur) dhe tri herë në mënyrë digjitale. Nga viti 2025 e tutje, Horizonte pritet të jetë vetëm në formën digjitale.

Për t'u siguruar që jeni gjithmonë të informuar kur numri më i fundit do të jetë i gatshëm në formë digjitale, ne kemi nevojë për adresën tuaj aktuale të postës elektronike (E-Mail) ose numrin tuaj të telefonit celular. Ju lutemi plotësoni formularin e duhur për t'u abonuar në «Horizonte» pa pagesë. Të dhënat do të trajtohen në mënyrë besuar.

Seminari i radhës i sindikalistëve shqiptaro-zviceran

Nivel i kënaqshëm i pjesëmarrjes aktive dhe bashkëkrijuese

Seminari i radhës në gjuhën shqipe, i organizuar nga drejtuesi i grupeve të interesit në sindikatën Unia Hilmi Gashi, u zhvilluar në Morges të Kantonit Waadt/Vaud të Zvicrës frankofolëse. Përmes prezantimeve, bashkëbisedimeve, shkëmbimeve dhe zotimeve të përbashkëta, u trajtuan tema të rëndësishme nga bota e punës dhe të drejtat sociale, organizimi sindikal e ai i komunitetit si dhe aspekte që kanë të bëjnë me të drejtat themelore njerëzore, si ato të solidaritetit përtej gjeneratave dhe gjinisë, gjithandë!

Osman Osmani

Seminari tradicional dyditor në gjuhën shqipe i sindikalistëve shqiptaro-zviceran ishte i dyti për sivjet. Pas shpjegimeve për qëllimin e synimet e seminarit nga organizatori Hilmi Gashi, kontribuuan me referime tematike edhe (ish)sindikalisti në pension Osman Osmani, me prezantimin e argumenteve mbi nismën për pensionin e 13-të të pleqërisë nga shtylla e parë AHV/AVS; i pasuar nga Hilmi Gashi, i cili prezantoi – duke i shoqëruar me shembuj konkret – mundësitë e përfshirjes dhe nevojën e pjesëmarrjes aktive në organizimin të strukturuar sindikal; pastaj Mimoza Kokollari nga qendra «Astre» në Lozanë, e cila në kuadër të çështjes së trafikimit të qenieve njerëzore, shpjegoi aspekte të shfrytëzimit të migrantëve e migrantëve – me theks edhe bashkëkombas:et tona – si fuqi punëtore; dhe Eduart Braka i mbështetur nga Hilmi Gashi shpjeguan fushatën «anëtarët bëjnë anëtarë», duke vu në pah rëndësinë dhe mundësinë që kanë anëtarët aktiv për të përfituar anëtarë të rinj për lëvizjen sindikale.

Të 20 pjesëmarrës:et e këtij seminarit, nga të cilët edhe të tillë që ishin për herë të parë në një seminar të tillë, ishin tejet aktiv në bashkëbisedim dhe dhanë edhe ide konkrete se si së bashku mund të kontribuojmë për



Seminari i zhvilluar në prag të Festave e Nëntorit dha shkas për t'i uruar të gjithë bashkëkombasët!

kushte më të mira pune e jetese edhe në moshë të shtyrë.

Përpos ideve shumica e tyre u zotuan që do të ndihmojnë edhe konkretisht gjithandë ku ata kanë mundësi për të kaluar votimi i nismës për pensionin e 13-të të AHV/AVS-it, sikur edhe që do angazhohen për përfitimin e kolegëve të tyre bashkëkombës dhe të tjerë si anëtarë për të fuqizuar më tej lëvizjen sindikale.

Në interesim të veçantë hasi edhe referimi i Mimoza Kokollarit mbi temën deri më tani paksa të tabuizuar të shfrytëzimit deri edhe keqtrajtimit të qenieve njerëzore si fuqi punëtore edhe nga vet bashkëkombë-

sit. Pyetjet e shumta dhe bashkëbisedimi kaluan kohën e paraparë për këtë temë, çka bëri të qartë nevojën e thellimit në këtë tematikë në seminarin e radhës.

Edhe sa i përket fushatës «anëtarë bënë anëtarë» bashkëbisedimi ishte shumë konstruktiv dhe premtues për të përfituar anëtarë të rinj për lëvizjen sindikale.

Pjesëmarrësit në fund të seminarit, pa përjashtim, u shprehën shumë të kënaqur me organizimin e mbarëvajtjen e seminarit dhe temat e trajtuara, për çka falënderuan organizatorin dhe referuesit si dhe mirënjohjen për atmosferën e shëndoshë e konstruktive të debatit të frytshëm për të gjithë.